

**Viola Isufaj**

**Që bota të mos mbetet pa muzikë...**

**Vetëdija letrare e Xhevahir Spahiut përkundrejt  
shformimeve të metodës socrealiste**

### **Përmbledhje**

Ky studim synon një shqyrtim sa më të plotë të veprës letrare të Xhevahir Spahiut, duke theksuar rolin e tij në formësimin e poezisë shqipe bashkëkohore përballë sfidave ideologjike dhe brezave të ndryshëm letrarë. Studimi thellohet mbi mënyrën se si Spahiu, me energjinë dhe risinë e tij unike, sfidoi paradigmen tradicionale dhe atë të realizmit socialist, duke krijuar një zë tjetër në letërsi, me pasuri figurative dhe thellësi shpirtërore e meditative. Poezia e tij përthyen peizazhin kompleks shoqëroro-politik, duke trajtuar tema të historisë, natyrës dhe rropatjeve ekzistenciale të shpirtit njerëzor, që japin konflikte të brendshme si dhe ndjesi të vetmisë a të veçimit, të trishtimit apo të shpresës.

Gjithashtu, analiza ndalet në poezi të një natyre tjetër, si ajo për vendlindjen, duke përkapur bukurinë natyrore, vlerat kulturore dhe kujtimet historike përmes imazheve të gjalla dhe një ritmi të strukturuar.

Punimi përfshin mendime kritike nga studiues si Robert Elsie, Shaban Sinani, Aliu Aliu ose poeti Ali Podrimja, të cilët e njohin atë si një figurë që esencializon qëndresën, vitalitetin e përtëritjen po dhe kërkimin e vazhdueshëm të ndërgjegjes njerëzore.

Teksti nxjerr në pah kontributin e Xhevahir Spahiut në sistemin e poezisë shqipe si një zë që vazhdimisht shtyn kufijtë e shprehjes poetike, duke bashkuar traditën me risinë dhe duke u angazhuar në reflektime gjithnjë e më të thella mbi identitetin, historinë dhe gjendjen njerëzore.

**Fjalë çelësa:** *sfida ideologjike, breza letrarë, realizëm socialist, vitalitet, përtëritje, dilema ekzistenciale, pasuri figurative, thellësi psikologjike, ritëm, risi.*

***Ecje e shpenguar, aq edhe e shpejtuar, me vrap, për diku. Për ku?***

– Nuk e di saktësisht pse –, sa herë e sjell ndërmend, më shfaqet në ecje sa të shpenguar aq edhe të shpejtuar, thuajse në vrap, për diku (Për ku?) – pyet studiuesi Ali Aliu pasi e ka përcaktuar Xhevahir Spahiun si *Poeti i formatit të madh – Mbase për në një cak të rëndësishëm, ku pritet ardhja e tij, ardhja që s'guxon të mënojë – për të ndrequr diç të pandreqshme – cak, ku pritet arti i tij poetik për të zgjuar a për të shpëtuar njeriun"?)*.<sup>1</sup>

Dhe desha ta nis me këtë portret që pashmangshëm do të na jetë përvijuar të gjithëve sa herë flitet për këtë poet dhe personalitet njerëzor.

Xhevahir Spahiu ka hyrë në poezinë shqipe me energji tërësisht individuale, me sinqeritet *sui generis* dhe kreativitet burimor. Udhën po ia çelte një intuitë e fortë poetike – ashtu si pohohet nga të gjithë, – me të cilën, do të vinte jo vetëm për të marrë vendin e tij në poezinë shqipe por edhe për t'ia pasuruar fytyrën poezisë shqipe.

Kjo është një linjë e re, e një brezi të rinjsh – me prirje kah modeli europërendimor i vargëzimit, i figuracionit dhe i strukturës poetike.

Xhevahir Spahiu e shoh të vendosur kështu në tri sfida ose, të paktën, në rrathët e tri marrëdhënieve të ndërlukuara:

**Sfida e parë ose marrëdhënia komplekse me trashëgiminë poetike shqiptare:** *Sistemi letrar shqiptar kishte njohur një fazë zhvillimi të mirë të të gjithë faktorëve në periudhën mes dy Luftërave, sidomos të repertorit, i cili ishte pasuruar ndjeshëm, me prurje modelesh të ndryshme që tashmë prireshin drejt modernitetit, përafritit të prodhimit letrar me letërsitë e tjera më të zhvilluara.*<sup>2</sup>

*Në letërsinë shqipe ishte vepruese një plejadë e papërsëritshme krijuesish si: Fishta, Poradeci, Koliqi, Kuteli, Migjeni etj., secili me një profil origjinal që si asnjëherë më parë përtheqsojnë dhe rrisin ndjeshëm përmasën estetike të tekstit.*<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Ali Aliu, “Koha e pamposhtur e poezisë”, sipas Xh. Spahiut në: *Udha*, Ideart, Tiranë, 2005, f. 7.

<sup>2</sup> Eldon Gjika, *Realizmi Socialist në sistemin letrar shqiptar*, Albas, Tiranë, 2019, f. 63

<sup>3</sup> Po aty: *Një grup tjetër krijuesish, përgjithësisht më minorë, si: Shuteriqi, Bulka Marko, Varfi, Çaçi, Musaraji etj., kërkojnë një prodhim letrar më pranë problemeve sociale të përditshmërisë. Ata grupohen rreth revistës Bota e Re, ku botojnë krijimet e tyre por dhe artikujt programatikë për kahjen që duhej të merrte letërsia shqipe. Gjithsesi te këta krijues... nuk vihen re gjurmë të realizmit socialist.*

\* Studiuesi Eldon Gjika nuk mbështet tezën e një ravijëzimi, në mos sajimi medoemos të një tradite pararendëse të rëndësishme të lëvrimit të Realizmit Socialist në letërsinë

Në të vërtetë, Spahiu e çmonte trashëgiminë poetike shqiptare, veçmas lirikën kombëtare. Studiuesi Ali Aliu, madje, e cilësonte atë të magjepsur nga kjo trashëgimi poetike shqiptare: *Me vete poeti bartte tërë trashëgiminë poetike shqiptare, ndaj së cilës, sidomos asaj lasgushiane e migjeniane, ishte i magjepsur. Do të mësojë edhe nga të parët, edhe nga të dytët, por do ta çajë rrugën e vet, mbase më të veçantën dhe më origjinalen në poezinë e re shqipe: kulti magjepsës ndaj fjalës do të jetë më i rreptë edhe nga ai i idhujve pararendës, edhe nga ai i bashkëkohësve të vet. Për të do të jetë i gatshëm të vërë kokën në litar.*

**Sfida e dytë është me brezin paraprijës:** Ne e dimë e gati ende e dëgjojmë zhurmën që vjen prej fillimit të viteve '60 midis brezave krijues.

Dhe është këmbëngulja për krijimin dhe njohjen e identitetit të një tjetër brezi krijues dhe sidomos insistimi për konfirmim që ka krijuar këto kundërshti të shprehura, po dhe të tjera të pashprehura me sistemin letrar bashkëkohor në përgjithësi (vetë sistemi e mendonte të mbyllur çështjen e ndërrimit të brezave) dhe brezin pararendës në veçanti.

Sipas studiuesit Shaban Sinani, *kjo ishte ana e inkurajuese e kohës. Tjetra anë ishte se brezi, që kishte bërë ndryshimin, kishte paralajmëruar në mënyrë sfiduese, ashtu si në Shkrimet e Shenjta: "Pas meje porta u mbyll". Porta e profecisë është mbyllur. Porta e poezisë është mbyllur. Të tjerët, që do të donin ta hapnin atë portë, do ta kishin vështirë edhe me mjeshtërit e tyre, të drejtpërdrejtë. Ata e kishin thënë shumë qartë se do t'ua tregonin vendin: përtej portës<sup>4</sup>.*

Xhevahir Spahiu është poeti që farkoi mjetet e veta të krijimit dhe hyri me mosbindje në mjedisin letrar që gjeti gati, një mjedis i stabilizuar fort jo vetëm në parimet krijuese, por dhe në hierarkitë e veta. Shumë shpejt ndodhi ballafaqimi i parë, do të cilësonte Shaban Sinani.

**Sfida e tretë është ajo me Realizmin Socialist:** Xhevahir Spahiu do të krijojë një imazh të ndryshëm poetik, që buron lirizëm dhe të përqendruar të marrëdhënia njerëzore universale.

Heroi i veprave të Realizmit Socialist heq dorë nga dashuria ose për hir të revolucionit, ose për hir të luftës së klasave, ose për hir të punës. Dashuria nuk mund të shfaqej si qenësi ekzistenciale.

Sintagmat me fjalën "dashuri" krijojnë valenca me leksema a togje të përcaktuara fjalësh: *parti, Enver, popull, klasë punëtore, komunizëm...*

shqipe përpara Luftës së Dytë Botërore: *Një mëtim i tillë do ta justifikonte realizmin socialist si një zhvillim diakronikisht natyral gjatë evoluimit të sistemit.*

<sup>4</sup> Shaban Sinani, "Poeti që hapi një portë të mbyllur", në: *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Naimi, Tiranë, 2010, f. 291-292.

Shí në mes të kësaj breshërie të rreptë përcaktorësh hedh shtatin e saj figura femërore e Spahiu e cila nuk do ketë lidhje me arat, fabrikat, kantieret, as me kazmat e lopatat, por do të vendoset mes tablosh të tjera: në një rast në një sfond vjeshte si një lloj vaji në kanavacë duke u njëjtësuar a tretur në trishtimin e saj, si tek poezia *Vjeshtë*:

*Dhe do t'i shkund gjithë gjethet e verdha/ Trishtimi i vjeshtës mbi ty le të bjerë,/ Që e trishtuar të mos duket pema.*

Xhevahir Spahiu, pra, pati tri sfida, atë që lidhet me poetët modernë të traditës, atë me shkrimtarët e viteve '60 e '70 dhe atë me idhtarët e realizmit socialist.

Të parët i admiroi dhe sintetizoi në artin e tij poetik; nga të dytët nuk pati drojë, teksa metodën krijuese socrealiste e tejkaloi.

Është poezia me prirje disidente që ndryshon tashmë historinë e zhvillimit të zhanrit duke krijuar një tjetër hartë letrare; mirëpo, shumë prej krijimeve letrare të Martin Camajt, një pjesë prej të Rreshpjes, asnjë prej të Zorbës nuk do ta shihnin dritën e botimit për 40 vjet ose nuk do njihnin komunikim me lexuesin shqiptar. Janë poezi antologjike pa asnjë dyshim, por të tilla që nuk shkonin dot kurrsesi drejt e në Tiranën zyrtare, kësisoj as në duart e lexuesit në kohën e shkrimit të tyre. Si të tilla ato nuk luanin dot rolin potencial të përçimit të kumtit kundërtotalitar apo të antimodelit të Realizmit Socialist përmes një forme të pazakontë për letrat shqipe.

Ndërkohë, si t'i kishin zbarkuar në një landfill masiv, poezitë e hershme propagandistike dhe patetike dergjen pranë njëra-tjetrës.

Dukshëm nga Xhevahir Spahiu nuk lind një poezi skajshmërisht moderne; ai nuk krijon një art që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, të hapur, kundërshtuese a rebeluese t'i kundërvihet doktrinës. Nuk do të ishte e mundur. Asgjë e tillë nuk mund të botohej në Shqipërinë totalitare, të represionit dhe censurës së ashpër të viteve '45-'90.

### **Në ç'koordinata do të vendoset Xhevahir Spahiu me krijimtarinë e tij?**

Sikur përtej dogmës të mos kishim disa poezi, le të themi, *të pavarura*, por domosdoshmërisht *të botuara*, do të kishim humbur gjënë më të rëndësishme: nuk do të kishim mundur të kapnim brenda kohës së zhvillimit të poezisë shqipe bashkëkohore kompleksitetin e ekzistencës dhe të shpirtit njerëzor në botën moderne. Këto janë *poezi* që simbolizojnë *shtrëngesa metafizike e sociale*, po edhe *rrugëtimin drejt ardhmërisë së zymtë*, përmes një *strukture poetike të re* dhe një *figuracioni me ekspresivitet të veçantë*.

Ai që mund të quhet *rebelim shoqëror* dhe *figurativ* i Xhevahir Spahiut ka lidhje me ligjërimin poetik, me leksikun, me motivet dhe me psikologjinë e heroit lirik, të cilat asfale nuk u pritën me dëshirë nga kritika e Tiranës zyrtare që orientoi politika dekurajuese ndaj kësaj poezie, sidomos dhe prej prirjeve formaliste të këtij autori dhe të brezit të tij.

Po si mundi të mos nyjëtohej në poezinë e Spahiut ku e vërteta dhe verbi poetik ishin të derdhura së bashku, – psikologjia e njeriut të kohës apo zhvillimet dramatike të vendit?

Xhevahir Spahiu sjell reflektime mbi identitetin dhe humbjen e individualitetit në shoqëritë totalitare, si në poezinë *Njeriu pa Emër*. Ai ndërthur ndjeshmërinë personale dhe ankthin ekzistencial, duke shprehur një ndjesi të humbjes së identitetit dhe dehumanizimit, që buron nga mungesa e njohjes së individëve si individë të lirë. Në poezi njerëzit pyesin për të, por ai është një njeri që nuk ka emër dhe është një figurë që ekziston vetëm në abstraksionin e një “balade” – një histori që është vetëm e treguar dhe jo e jetuar.

Kurse poezia *Ora* është një poezi introspektive që merret me kalimin e kohës, dashurinë, dhe ndjenjat e pasigurisë që i shoqërojnë këto përvoja. Poezia është e mbushur me imazhe mbresëlënëse që krijojnë tensionin mes jetës dhe vdekjes, mes dashurisë dhe humbjes, dhe mes kalimit të kohës dhe dëshirës për përjetësinë.

Në poezi, Spahiu përdor tingujt e “tik-taku”-t të orës dhe të zemrës për të përcjellë kalimin e pafund të kohës. *Mbi parvaz; Tik-taku i ores; / Mbi krevat Tik-taku i zemres* – krijojnë një ndjenjë të tendosur, ku koha dhe jeta përzihen me njëra-tjetrën. Poeti lidh këto tinguj me trupin dhe ndjenjat e tij, duke e bërë kalimin e kohës të ndihet si një puls i gjithanshëm. Imazhi i *varkës së Noes* në fund të poezisë është një metaforë e thirrjes për shpëtim dhe e një dëshirimi për të mbijetuar në botën e shtanguar.

Prandaj dhe Dritëro Agolli do ta cilësonte poezinë e Spahiut si një poezi me përplasje idesh, me një frymë lirike dhe zhvillim dramatik të vargut, me një figuracion të plotë, por kryesisht me ide të thella, tronditëse.

Ali Podrimja do ta çmonte këtë poezi si nevojë shpirtërore-shoqërore-historike të një individi të angazhuar e artisti të njëmendtë në këtë kohë krizash botërore e shqetësimesh tronditëse. Brenda kreativitetit, atë që rrëfen heroi lirik thuhet pa ngurrim e halë në gjuhë, me dashuri e bukuri, e angazhuar dhe njëherësh fine, me nerv dhe njëherësh fisnike, është një poezi polivalente dhe me nëntekstin ka shqetësimin e kohës dhe lëvizjen e saj – do të vijonte ai.

### Vetëdija e poetit dhe estetika që e përcjell atë

Xhevahir Spahiu diti të përballej, t'i kundërvihet së keqes dhe të mbijetonte.

Poeti na tregon se kujtesa, edhe pse e bukur, mund të jetë një barrë që na lidh me të kaluarën dhe na mban peng në një kohë të shkuar, të pabukur, ku mund të mbetemi të ngujuar. Harrimi, nga ana tjetër, çmohet si diçka më e bukur se kujtesa, e kjo nënkupton se çlirimin nga e kaluara dhe mundësitë për t'u arratisur nga trishtimi i realitetit të tashëm mund ta realizojë vetëm një lloj qetësie që duhet të jetë e aftë të përballojë të ardhmen e pezulluar.

Poezia *Mbi kohët arkaike një qiell i zbrazët dimri* e cila përfshihet në ciklin *Kohë Moderne* (1989), është një tejqyrë e pasur e tendosjeve që shoqërojnë kalimin e kohës dhe përballjen me historinë dhe ndryshimet shoqërore. Poezia mbart ngarkesë filozofike e cila gjen tërësinë më të përshtatshme të mjeteve estetike për t'u përcjellë te lexuesi: simbolika dhe metaforika e tij lidhen me qiellin dhe dimrin. Poezia fillon me një qiell të zbrazët dimri, që shenjon një periudhë të ftohtë, të pashpresë dhe të errët, ku mungon ngrohtësia dhe vitaliteti, një figurë e pastër që shenjon boshllëkun dhe stagnimin e një kohe, ngrirjen, një metaforë për një epokë të heshtur e të mpirë, kur mund të dëshirohen ndryshime shoqërore ose politike, por që në fakt, nuk bën lëvizje; asesi përparim:

*Mbi kohët arkaike një qiell i zbrazët dimri.*

*E bukur kujtesa,*

*po më i bukur harrimi. (Kohë moderne, 1989)*

Harrimi, ky lloj çlirimi, sjell megjithatë një humbje të lidhjes me të kaluarën, një lloj distancimi nga ajo që kemi përjetuar.

Gjuha duket e thjeshtë, por e mbushur me ambiguitete. Vargjet janë të shkurtra dhe të përqendruara, ato nxjerrin në pah thelbin e një kumti, pa përdorur fjalë të tepërta.

Akulli, era, dimri dhe vera janë të pranishëm në poezinë e Spahiut si elemente që përfaqësojnë ndjeshmëri të thella. Akulli, për shembull, është shenjë e ftohtësisë dhe e ngrirjes së ndjenjave dhe mendimeve. Kurthi i ditës dhe nata janë një tjetër metaforë për ciklet e jetës që përsëriten, pa ndryshuar.

Jo rrallë në poezitë e tij, Xhevahir Spahiu përfiton një pasqyrë opake të asaj që mund të jetë një periudhë e errët dhe e ftohtë e historisë, ndërsa opozicionet mes elementeve të natyrës bartin tension të brendshëm të individit dhe kohës kur i ka rënë për short të jetojë, p.sh., përkundrejt qiellit rozë dhe entuziazmit e patetizmave propagandistike, poeti ka krijuar një atmosferë të rëndë dhe mbytëse në poezinë me titull *Zezone*. Kjo është një poezi e ndjeshmërisë dhe e dëshpërimit të njeriut. *Zezone* është e mbushur me pamje të

errëta dhe simbole të vetmisë dhe të dhimbjes që përcjellin një luftë të brendshme të individit me veten dhe realitetin e hidhur në të cilin ka rënë. Poezia bart reflektime për ekzistencën.

Pohimi i rrallë për poezinë shqipe të botuar nën realizmin socialist: *mungesa e vetmisë më ka munduar, tani i vetëm ndihem, si në morg*, na sjell ndjesinë e izolimit të thellë dhe dhimbjen e shkatërrimit të brendshëm. Morgu, si një simbol i fundit dhe i vdekjes, sugjeron se individi (përkundrejt *Njeriut të Ri* socialist) është kaq i humbur dhe i dërrmuar, sa që ndien si të ishte tashmë i vdekur shpirtërisht.

### **Iluzionet dhe shkatërrimi i tyre-përkundrejt ndërtimit të “së resë”**

Poeti flet për *rrënojë iluzionesh*; ndjenja e zhgënjimit është e përhershme përkundrejt optimizmit rozë që impononte metoda. Kjo shkatërron çdo shpresë të mbetur gjallë dhe e lë individin të ndjehet i ngecur, i humbur dhe i pafuqishëm për të përballuar realitetin.

Edhe poezi të tjera ashtu si poezia *Zezone* shkruhen me tone të rënda, të mbyllura dhe përthyejnë një luftë të brendshme të individit për të kuptuar veten dhe për t’i qëndruar një realiteti që është i padurueshëm. Këto poezi shprehin vetminë si pasojë e humbjes së besimit tek idealet e ëndrrat e mëparshme. Poezi të tilla kanë të përbashkët një thirrje të heshtur drejt thellësive të vetëdijes dhe një përballje me të vërtetën e hidhur të ekzistencës.

Përkundrejt rënies në abis të poezisë pas Plenumit të Katërt, përkundrejt ligjëritimit bisedor e zhargonit të komunikimit të *klasës punëtore*, përkundrejt folklorizmit të thatë dhe tematikës mbi luftën e klasave, armiqtë e pushtetit e të revolucionit, si dhe, nga ana tjetër përkundrejt himnizimit të figurës së udhëheqësit, erdhi kështu mërzia ekzistenciale, përsiatja, mëdyshja e njeriut – e bashkë me to dhe një ton rragimi për vetmi, por dhe dëshira e fortë për të shpëtuar nga rutina e pandryshueshme dhe për të provuar diçka që mund të turbullonte a të ndërronte gjendjen e ndenjur:

*Shushurijnë shelgjet në fushë, shushurijnë;  
mërmërijnë mizat në mriz, mërmërijnë.*

*O Zot,*

*lësho një bubullimë. (Monotoni, 1986)*

Spahiu, përmes një mjedisi të mbushur me tinguj të përsëritur dhe të pandryshueshëm ka krijuar këtë atmosferë monotone dhe të ngadalshme që transmeton ndjesinë e mbylljes.

*Shushurijnë shelgjet në fushë, shushurijnë” dhe “mërmërijnë mizat në mriz, mërmërijnë”, nënkuptojnë tinguj natyrorë, që përsëriten pa ndalim dhe*

më një qetësi të padurueshme, një simbol i asaj që ndodh në jetën e individit kur gjithçka bëhet e pafundme, e përhershme dhe e pashpresë.

Thirrja për ndryshim: *O Zot, lësho një bubullimë*, është thirrja e poetit për një ndryshim radikal që do të shkëputë këtë atmosferë të mërzitshme, është një kërkesë për diçka të jashtëzakonshme, një shpërthim emocional më shumë se natyror që ndoshta do të ndihmonte për të prishur rendin e së përhershmes.

*Ç'mënxyrë ia ul kokën  
asaj pishë që s'tundet?  
Çdo ditë mbi të një sorrë shkon e ulet. (Zezonë, 1981)*

Në këtë poezi, sorra që ulet mbi pishë sugjeron një prani të keqe dhe të padëshiruar që sjell vuajtje, shkatërrim, poshtërim.

Pisha që nuk tundet dhe sorra që e viziton çdo ditë janë elemente që na shpiten në mënyrë groteske në një realitet të errët dhe të ngadaltë, mbi të cilin ke qëndruar me kokën lart, por në të cilin vjen e të përbuz një qenie e mjeruar që të shndërron në një pre të humbjes së energjisë vitale dhe të asaj krenarie që ta jep vetëm dinjiteti njerëzor.

Përkundrejt kërkesave të Realizmit Socialist, poezia e Spahiut ngërthen mesazhe të fuqishme mbi pasivitetin dhe tragjizmin e ekzistencës njerëzore, përballjen me sistemet politike dhe shoqërore dhe fatin që mund të jetë i pandryshueshëm dhe i paevitueshëm.

*Kam parë një pyll të tërë me shelgje,  
të gjithë të krrusur  
sipas urdhërit të erës së rreptë.  
Kam parë dhe majë malit një pishë të vetme,  
të djegur nga rrufeja,  
po të drejtë! (Një pyll me shelgje dhe një pishë e vetme, 1972)*

Shelgjet që janë të kërrosura *sipas urdhërit të erës së rreptë*, përfaqësojnë një masë të shtypur, një grumbull individësh që veprojnë nën ndikimin e një force të jashtme, në shkallë të madhe. Kjo shenjon shoqërinë shqiptare, e më në përgjithësi, secilin popull a bashkësi njerëzore që është detyruar të përshtatet dhe të mbijetojë nën një sistem të padrejtë që i kontrollon dhe kufizon lirinë.

*Rrufeja* përfaqëson shkatërrimin që mund të vijë nga lart dhe të jetë jashtë kontrollit të individëve.

*Pisha*, që është e vetme në majë të malit, *të djegur nga rrufeja*, është simbol i individëve që kanë zgjedhur më mirë të ndihen të izoluar, të vetmuar dhe të përballur me mundësi të pamundura për të mbijetuar sesa t'u përkulen sistemeve represive. Pisha e vetme duket se paraqet një individ të guximshëm, që përpiket të dalë nga masa e zakonshme, por që e gjen veten të shënjestruar

nga forcat që janë më të fuqishme se ai dhe si rrjedhojë e kësaj vjen dhe shkretimi: rrufeja e godet dhe e djeg. Këto fjalë bëhen shprehje e paevitueshmërisë së fatit dhe shkatërrimit për atë që qëndroi. Ky imazh të cilin e interpretojmë në radhë të parë si një figurë të jetës së një njeriu që përpiket të ngrejë kokën mbi masën e zakonshme, por që përfundon i asgjësuar nga fuqi arbitrare që nuk mund të kontrollohen, shoqërohet me cilësimin: *po të drejtë!* – në fund të poezisë. Pisha është e vetme dhe e dërrmuar, por kjo është mënyra e vetme e përbaljes me dinjitet me sistemet: çdo individ që del jashtë normës apo që sfidon rregullat e shoqërisë përballet me pasojat e këtij akti.

**Kontrasti mes kolektivitetit dhe individualitetit:** Ne analizuam si poezia nënkupton se ndonjëherë individët që dalin nga masa, që tentojnë të dalin nga uniformiteti, janë të ekspozuar ndaj goditjeve të padrejta dhe fatkeqësive që nuk mund të parashikohen. Shelgjet, të kërrusura nga era, simbol i pasivitetit dhe i nënshtrimit ndaj forcave të jashtme dhe pisha e vetme, simbol i individëve të veçantë që përpiqen të qëndrojnë të palëkundur, por që shpesh i pret përbalja me një fat të dhimbshëm, që nuk e kanë merituar – krijojnë një kontrast të fortë edhe midis *kolektivitetit dhe individualitetit*.

Simbolet universale nga natyra dhe ligjshmëria e saj dhe metaforat e gjetura, i japin poezisë një ndjesi të thellë dhe universale, duke esencjalizuar luftën e individit për të mbijetuar përkundëjt masës në një botë jo vetëm totalitare, por në çdo botë që të padrejtë dhe të pamëshirshme.

Dhe është ky kontrast i cili hyn mirë në thelbin e gjërave – që na sjell dhe një herë tjetër një reflektim mbi fatin, tragjizmin dhe pasivitetin e jetës në sistemet represive, ku individët shpesh nuk mund të bëjnë asgjë për të shmangur shkatërrimin që vjen nga fuqitë e jashtme.

**Përkundër ideologjisë, patetikës dhe mjeteve shprehëse të realizimit socialist:** Mund të vërehet njëkohësisht kontrasti me ideologjinë, patetikën dhe mjetet shprehëse të realizimit socialist dhe një *frymë e re*, padyshim, e ndryshme nga ajo e vitit 1960. E qartë, tashmë kishte lindur një poezi tjetër.

*Pemë po të isha e të mbija ndanë lumit  
Do të gjelbëronin shpresat, do të binin prej meje  
fletët e trishtimit  
Mbi degët e përkulura do të thithej bora e do të  
ulërinte era  
Degët do të ëndërronin  
Të vinte pranvera...  
Do t'i ftoja zogjtë  
Të vinin tek unë të ngrinin fole,  
Të ulëshin, të cicëronin një çast mbas shtegëtimit,*

*Mbi mua pastaj papritur të vërshenin ujërat*  
*E trungun dallgët të ma rrihnin,*  
*Zogjtë le të iknin, në liri*  
*Të iknin...*  
*Fëmijët të kacavireshin,*  
*Gjethet t'i këpusnin për herbariumet e tyre,*  
*Mbas turnit, punëtorët të pinë cigare*  
*Me pëllëmbët e trasha si dy copë trungje,*  
*Mbi gjoksin tim ku mbështetet Arusha,*  
*Djema,*  
*Mbështesni shpatullat e vajzave të bukura.*  
*Jam ai që s'kam qenë,*  
*Do të jem ai që nuk jam.*  
*Trungun tim druvarët le të vinë e të presin*  
*Në tokë, në kohë e në zemra,*  
*Rrënjët –*  
*Për t'u rilindur sërish le të mbesin.*  
*Me drurin tim le të bëjnë gjithçka,*  
*Por jo arkivole,*  
*Mbi krye le të kem vetëm qiellin e madh,*  
*Nën këmbë – as hije,*  
*Mbi tavolinat e bëra nga trupi im,*  
*Mbështesni bërrylat,*  
*Bini në mendime.*  
*Jam ai që s'kam qenë*  
*Ai që do të jem nuk jam. (Jetë, 1972)*

Poezia *Jetë* nga Xhevahir Spahiu kondenson një shqetësim filozofik dhe ekzistencial mbi jetën, identitetin dhe fatin e individit, qenien dhe hiçin përmes një ndërthurjeje të botës natyrore me atë njerëzore për të krijuar një ndjesi të pasigurisë, të shqetësimit dhe sërish e sërish: të mundësisë së ndryshimit, në kuptimin e rilindjes dhe përtëritjes.

Poezia është e mbushur me potencial të *transubstantimit*, natyrës dhe ndryshimeve e përndërrimeve për të cilat uni bëhet fli (*Kur të vdes, le të bahem gur* – kështu do ta kërkonte shndërrimin poeti që shkruante dhe botonte jashtë kufijve të Shqipërisë Martin Camaj, pa kontakte me marrësin e këtyre anëve).

Sado, në një kontekst krejt tjetër, nuk mund të mos na ndërmendë këtu si një strukturë arketipore mendore konceptimin e Xhojsit në *Uliksin* e tij.

Xhojsi, sidomos në romanin *Uliksi* (1922), e përdori konceptin e transubstantimit në mënyrë ironike dhe moderne. Protagonisti Leopold Bloom, gjatë drekës, përfytyron ritualin katolik të Meshës *Eat the body. God becomes man becomes bread becomes eaten*. Xhojsi e përdor transubstantimin edhe për

të treguar transformimin e përditshmërisë banale në diçka të shenjtë, përmes vështrimit artistik. Në këtë kuptim, mund të gjejnë vend interpretime të tjera: transubstantimi bëhet metaforë për artin: siç buka bëhet trup hyjnor, edhe jeta e zakonshme bëhet letërsi e shenjtë.

*God becomes fish becomes barnacle goose becomes featherbed  
mountain (Xhojs, Uliksi)*

Kjo fjali – si pjesë e përfundimit të kapitullit – përfaqëson një zinxhir transformimesh: forma që ndryshojnë, që rrëshqasin nga njëra në tjetrën, në përputhje me natyrën fluide të bregut. Ku fillon toka dhe ku mbaron deti? Gjithçka është relative, në vazhdimësi formash që mbivendosen: rëra, uji, dallgët.

Çdo formë është ciklike, çdo formë mban potencialin për t'u kthyer në hyjni. Asnjë formë nuk është fundi.

Të gjitha janë të ndërlidhura, të “bashkëqena” deri te patat e egra, të zbutura, që dhurojnë puplat e tyre për të mbushur jastëkët që më pas shndërrohen në vende të pasionit dhe të tradhtisë (ndonëse në këtë rast marrin në kuptim metaforik e prapë ironik: vend i infidelitetit, dëshirës, pushimit, dhe dhimbjes).

Sipas teozofisë, gjithçka është e unitarizuar në materie dhe shpirt, ndaj çdo gjë mund të shihet si shenjë e pranisë së Zotit. Një gur i thjeshtë mban potencial hyjnor. Ndryshimi ndodh gradualisht, në faza – por secila formë mban kujtimin e formës më të hershme.

Mirëpo *Pema* në poezinë *Jetë* e Xhevahir Spahiut me degët dhe rrënjët e saj, është mbi të gjitha një simbol i ciklit të jetës, i pasigurisë dhe i ripërtëritjes në trajta dhe funksione të tjera. Poeti kërkon një formë shprese dhe lirie përmes pemës; fletët që bien janë simbole të trishtimit dhe kalimit të ditëve të vështira në një të ashtuquajtur liri, por gjithashtu, ne do ta shohim pemën të ofrojë mundësi për ringjallje dhe për liri të njëmendtë. Kur zogjtë shkojnë nëpër degët e pemës, ata simbolizojnë mundësinë për një shpërthim të mundshëm.

Mbi pemën kalon një varg imazhesh që lidhen me kalimin e kohës dhe me ndikimin në shoqëri. Pema, si një strukturë e natyrshme, përballet me çdo sfidë që i sjell jeta – bora, era, fëmijët që e prekin dhe ata që vazhdojnë në të përditshmen e tyre. Poeti kërkon që trangu i pemës të mbetet, që rrënjët të jenë të gjalla për të ndihmuar ringjalljen dhe vazhdimin e jetës, ndonëse ky proces mund të kalojë përmes dhimbjes dhe rreziqeve për shkatërrim.

**Një dëshirë dhe një thirrje për të kaluar përtej kufizimeve:** Rrënjët e pemës janë të lidhura me të kaluarën dhe me jetën që ka rrjedhur, por ato janë gjithashtu aty, si për të na kujtuar një mundësi për të ringjallur çdo gjë që është shkatërruar ose është humbur.

Imazhi i drurit të prishur, por jo të shkatërruar plotësisht, i jep lexuesit një kumt për të qëndruar të fortë dhe të hapur për mundësinë e kalimit në cikle të tjera, rrënjën e të cilit besojmë se Spahiu e ka gjetur së pari te filozofia sufiste, ndikimet e të cilës (metaforat, simbolet dhe bota mistike e Baba Tomorrit me imazhin e të cilit ishte rritur) ndihen herë pas here në poezinë e tij.

*Fjalët e Qiririt* e Naim Frashërit është një shembull domethënës në poezinë shqipe i transubstantimit poetik dhe filozofik. Ajo që ndodh te Naimi është një shndërrim metafizik dhe simbolik i unit poetik në elemente të ndryshme të natyrës dhe kozmosit.

*Edhe unë si ju jam ndruar  
e jam përzjer' e ndryshuar  
Pa jam bërë shumë herë  
zjarr e ujë e baltë e erë.  
Jam një shkëndijë pej qielli  
dhe një drudhëzë pej dielli.  
Edhe ndër qiej fluturonj,  
edhe brënda në det qëndronj (N. Frashëri, *Fjalët e qiririt*)*

Substanca (thelbi, “çfarë është”) – esenca e brendshme që e bën një gjë atë që është dhe dukjet e jashtme – ngjyra, shija, forma, madhësia mund të lidhen me transubstantimin (ndryshim i thelbit) apo me besimin filozofik dhe spiritual që shpirti i një qenieje të gjallë, pas vdekjes, rikthehet në një trup tjetër, njerëzor ose jo e ky trup mund të jetë një njeri tjetër, një kafshë, bimë, ose edhe ndonjë formë tjetër jete.

Ne mund të shikojmë këtu edhe konceptin e transmigrimit të shpirtit, metapsikozën dhe lidhjet e Spahiut jo vetëm me shpirtin naimian, po dhe me kontekstin e filozofisë së lashtë greke të rikontekstualizuar në poezinë e tij. Megjithatë, mbi të gjitha këto ndikime të mundshme, dallojmë:

- Shndërrimin e unit në elemente: Xhevahir Spahiu (ose figura simbolike e tij në qendër të kësaj poezie) përshkruan vetveten si të shndërruar në pemë – (ngjashëm si Naimi shndërron veten në katër elementet klasike të filozofisë së lashtë, të cilat Aristoteli i konsideronte si përbërës të çdo gjëje në natyrë). Ky është një transubstantim filozofik i qenies në bazë të strukturës së universit.

- Metaforën e unit të shpërndarë: Duke qenë se subjekti poetik shpall se nuk është i kufizuar në një formë, atëherë, ai është një shpirt i përjetshëm dhe i lëvizshëm, që merr forma të ndryshme, duke sakrifikuar veten për natyrën dhe njerëzit për mirësinë e përgjithshme.

- Ekuivalencën shpirt-materie: Si në transubstantimin katolik, ku materia shndërrohet në substancë shpirtërore, edhe këtu kemi një ndryshim të qenies: poeti shndërrohet në elemente të natyrës, por mbart brenda tij shenjtërinë e flijimit dhe të vetëdijes shpirtërore.

Pra, po shohim sesi ai bashkon shpirtin dhe natyrën; aty sakrifikon veten dhe shndërrohet në elemente që e ndihmojnë jetën: fole për dritë, gjallëri e lojëra për fëmijët, tryezë për të mbështetur bërrylat e për të rënë në mendime, mbështetje për shpatullat e vajzave të bukura që do t'i sjellin djemtë, për dashuri e ëmbëlsi.

- Ndalimin dhe reflektimin ekzistencial: le të qëndrojmë dhe për pak te rikontekstualizimi i filozofisë së shndërrimit, idesë së kalimit në cilke të tjera, apo *formave që ndryshojnë, që rrëshqasin nga njëra në tjetrën*:

*Jam ai që s'kam qenë, Do të jem ai që nuk jam* – janë vargjet vatrore që shpjegojnë këtë rikontekstualizim. Ato janë në këtë poezi për të shprehur një ndjenjë të fortë të dyshimit, sidomos dhe të ndryshimit të identitetit. Poezia shtron pyetje rreth asaj që është dhe asaj që mund të jetë njeriu, duke nënkuptuar këtu që identiteti dhe ekzistenca janë gjithmonë në një gjendje të vazhdueshme ndryshimi dhe reflektimi – dhe jo të pandryshueshëm, të patundshëm e të palëkundshëm (në besnikërinë ndaj ideologjisë, siç i kërkonte heronjtë lirikë ideologjia e realizmit socialist).

Poezia ndërthur tensione midis jetës dhe vdekjes, së tashmes dhe së ardhmes, shpresës dhe trishtimit. Këto kundërvënie janë theksuar edhe në përdorimin e formës filozofike të vargjeve ku njeriu është në një gjendje të paqartë apo të papërcaktuar përfundimisht të identitetit dhe ekzistencës – dhe nëse ekziston një e vërtetë e palëkundshme, kjo është vetëm dhe pikërisht ky relativet i gjërave.

Udhëheqësi komunist, Enver Hoxha, në fjalën e mbajtur në Presidiumin e Kuvendit Popullor, më 9 janar 1973, midis *direktivave për artin dhe letërsinë* do të thoshte se *Xhevahir Spahiu dhe disa poetë të rinj kanë shumë ide, por mënyra se si i shprehin ato nuk është gjithmonë reale, jetësore*.

Në fakt, gjuha e poetit është e pasur me metafora dhe simbole që lidhin natyrën me jetën njerëzore. Përdorimi i vargjeve filozofike dhe lëvizja nga e tashmja në të ardhmen shprehin një tension të madh ekzistencial, një kërkesë për kuptim të thellë dhe përtëritje, sepse të gjitha sistemet njerëzore kërkojnë përtëritje.

### **Përkundrejt goditjeve në art- një sistem individual strukturash e përftesash**

Spahiu akuzohet për ndikim nga “Ekzistencializmi i Sartrit”, çka e vendos poetin në pozita të vështira, të brishta, pothuajse të rrëshqitshme me realizmin socialist, me estetikën marksiste dhe me vetë sistemin politik që ishte ngritur mbi këtë filozofi. Mund të akuzohej se kishte rënë në kthetrat e dekadentizmit.

Por lipset kujtuar dhe sot sesi shihej ekzistencializmi prej Tiranës zyrtare: thjesht në prizmin e një botëkuptimi pesimist për jetën: vetëm theksohej se ai

mohon karakterin objektiv të qenies, këndvështrimin mbi njeriun si *një qenie abstrakte, e shkëputur nga shoqëria, klasa, shtresa në të cilën bën pjesë*, duke u përqendruar sidomos tek gjendje të tilla *negative si frika, vetmia, ankthi*.

Përkundrejt optimizmit të rremë dhe së ashtuquajturës *qartësi në arte, karakterit popullor*, ja sërish shfaqet njeriu i Spahiut që nuk mund ta kuptojë veten plotësisht, ja poeti dhe uni i tij, tashmë i vendosur në kuadratin e njeriut të prirur për gabime, mosbindje, për rebelim estetik...

Krijimtaria e Xhevahir Spahiut edhe pas kritikave e goditjeve nuk pësoi shformime estetike në thelb. Ai ishte një poet, që kishte të formuar një sistem të vetin konceptual, figurativ e gjuhësor. Në kontrast me frymën entuziaste apo industriale, në aventurën e Botës së re dhe të Njeriut të Ri, Xhevahir Spahiu orvatet ta ruajë poezinë në profilin e saj strukturor dhe lëndor.

Ai transformoi sistemin dominant jo aq në nivel politik, sesa në nivelet e thella dhe filozofike të krijimtarisë.

Ai sjell në poezinë tonë modelin poetik të shpirtit të André Breton-it, Paul Éluard-it, Robert Desnos-it, Louis Aragon-it, që mbart një angazhim që nuk e redukton formën poetike, siç ka ndodhur shpesh në avangardat botërore dhe siç ndodhi në shumicën e poezisë së realizmit socialist në Shqipëri. Poezia e tij mbruhet me një lloj militantizmi, të cilin Xhevahiri nuk e fsheh as si koncept krijues dhe as si vetëdije qytetare, militantizëm që shfaqet më tepër si projekt vizionar për ndryshimin e rendit të vlerave, por që nuk e tradhton për asnjë çast etikën e vet të formës estetike.

Në këtë mënyrë, poeti nuk i jep poezisë as atributet e dokumentit, as rolin didaktik, dhe as të profecisë. Duke qenë përherë i vetëdijshëm për tekstin poetik “si strukturë e shenjave ambigue”, Xhevahiri i pranëvendos kësaj strukture thelbe filozofike që lidhen me kërkesën e tij për pozicione të reja të njeriut dhe shoqërisë. Në poezinë e tij është dominante lëvizja si dimension i përjetshëm i universit. Siç thotë vetë poeti, “edhe nga pika e vdekjes (ai) do t’i këndojë lëvizjes”. Kjo më shumë se një metaforë është pjesë imanente e poetikës krijuese të Xh. Spahiut. Metafora dhe metamorfoza, që përdoren dendur në poezinë e tij, e njëjtësojnë poetin me shiun që do t’u shtojë blerimin maleve të tija, me lumin që çon ujë në det dhe e bën këtë të fundit më të fuqishëm për lundrim, me ëndrën që të çon te e ardhmja<sup>5</sup>.

Lëvizja dhe ndryshimi që kërkon poeti përmes poezisë prek gati të gjitha impiantet themelore të ekzistencës si prani dhe si jo e tillë. E kërkuar e gjitha kjo në kontekstin e një shoqërie totalitare, siç ishte ajo para viteve ’90 ose gjysmëtotalitare, siç e koncepton Spahiu shoqërinë tonë të pasnëntëdhjetës, bën që vepra e tij poetike të vendoset në pikëtakimet midis herezisë dhe utopisë.

<sup>5</sup> Shih në veçanti Adem Jakllari, “Xhevahir Spahiu midis “Herezisë” dhe utopisë”, botuar në *Studime Albanologjike*, aktet e konferencës Homo Poeticus, Homo Politicus, Tiranë, 2012, f. 129.

Padurimi metafizik është dominante e dytë e fortë dhe e pandashme në poezinë e tij. Edhe pse Xh. Spahiu e ka një linjë dominante që është e pranishme në të gjithë hapësirën kohore prej para viteve '70, megjithëse në mes ka një rapturë të fortë filozofike dhe estetike, poezia e tij është tejet koherente, veçanërisht në frymën rebeluese dhe projektin e saj utopik.

Padurimi metafizik i jep trajtën dhe ritmin poezisë dhe e mban atë brenda matricës së një poezie të angazhuar në rrafsh të civilizimit dhe përsosjes së njeriut. Ky padurim dhe kjo ngutje e tij për të thyer tabu dhe ndërtuar utopi – një prej të cilave, në mos kryeutopia, është ajo e besimit se poezia do ta përsosë njeriun – e çon shpesh te koncepti hegelian i një divinizimi të poetit që beson te një inspirim më i madh. Duket si paradoks që një poet shqiptar, i edukuar në një shoqëri komuniste, të shfaqë në artin e tij shenja të një formimi filozofik dhe estetik krejt të kundërt me doktrinën zyrtare. Por, ndërkaq ai paradoks ekziston; Xhevahir Spahiu e ka kredo poetike konceptin idealist se bukuria që vjen prej poezisë e bën më të mirë botën<sup>6</sup>.

Spahiu dashuronte njeriun në gjithë botën e tij dhe jo në pjesë të ndara apo utopiste të tij, idealin humanist: *të bukurën*, siç vinte nga tradita shqiptare që prej Naim Frashërit, dhe më herët ende, prej lirikës popullore.

Poezia *Dashuri* p.sh. është pjesë e vëllimit *Mëngjes sirenash*, e cila e shikon dashurinë në përmasë njerëzore dhe pothuajse mistike, ndjenjë që nuk mund ta deformojë as njeriu i ri i revolucionit që dashurinë duhej ta gjente në gjirin e kolektivit.

Poeti Ali Podrimja do të vlerësonte: *Poezia e këtij poeti, njërit ndër më të talentuarit e poezisë sonë të modernitetit, mahnit me sensibilitet dhe qasje. Duke u përballur me përmbajtje, ide, figura dhe mesazhe, hetohet se shkrimin e poezisë, nuk e pranon si vargnim por si mjeshtri, art, si nevojë të domosdoshme shpirtërore shoqërore – historike, të një krijuesi të angazhuar e të njëmendtë në kohë krizash e shqetësimesh traumatike.*

Ndërkohë që koncepti socrealist e kishte çngjyrosur poezinë dhe gati nxjerrë atë nga funksioni i saj estetik, do të vërehej: *përpyjekja dhe insistimi i vazhdueshëm për të mos e shndërruar poezinë në traktat politik, në pllakat dhe fletërrufe.*

Gjithashtu: *Poetët e brezit të ri përpiqen të vënë njëfarë drejtpeshimi midis këtyre komponentëve në poezi, duke synuar njëkohësisht që të dalin nga ky rreth vicioz i temave, motiveve subjekteve dhe ideve 'të preferuara', në njërën anë dhe metaforave, epitetëve, krahasimeve dhe figurave të tjera standard dhe të konsumuara, në anën tjetër.*

Jo vetëm Podrimja, por edhe Ali Aliu ka shkruar për veçantitë e përzgjedhjes së fjalës, ashtu edhe strukturën e ngjeshur organizuese të poezisë

<sup>6</sup> Po aty, vëllim i cituar më sipër.

së Spahiut, natyrën sintetike, të kursyer, shpesh alegorike, por edhe të vargjeve që kanë peshën e fjalëve të urta, apo sentencave filozofike.

Le të vijmë tani, në fund, te poezia *Skrapar*, një krijim shumë i bukur, i cili dashurinë dhe emocionet për vendlindjen i jep përmes figurash që përçojnë forcë dhe intensitet brenda ndjenjës së identitetit dhe lidhjes me natyrën e historisë e këtij vendi plot shenja të veçanta. Poeti përdor një strukturë strofe dyshe, që siguron ritëm të qëndrueshëm dhe harmoni në shprehjen e mendimit dhe të emocionalitetit.

*Male kapriçioze me formë të çuditshme,  
Njerëz me zemër të madhe fisnike.  
Muzgu si parashutë vigane po bie,  
Muzgun e shpojnë këmborë dhe zile.  
Në shpatet, që mbajtën beteja mbi supe,  
Nata mbi grurë dhe vreshta po ulet.  
Grykat e maleve, grykat e lugjeve –  
Të thella, të ngushta si grykët e pushkëve.  
Mbi maja: burbullojnë zjarre që s' shuhen,  
Mbi shkrepë: Harusha e Madhe përkulet.  
Peisazh i ngatërruar i tokës skrapare:  
Astronom, ku janë yjet? Bari, ku janë zjarret?*

*Malet “kapriçioze”* dhe me forma të çuditshme të *Skraparit* japin bukurinë dhe veçantinë e natyrës së vendit. Pas këtyre maleve, njerëzit që jetojnë atje kanë lidhje të ngushtë me vlerat e nderit dhe besnikërisë.

*Muzgu*, bie si “parashutë vigane”, një metaforë që sugjeron një pamje të bukur dhe të papritur të natës që mbulon gjithçka me një ndjenjë të ëmbël dhe madhështore. *Muzgu* shpohet nga këmborët dhe zilet, duke sjellë një lidhje të ngushtë mes natyrës dhe kulturës vendore të jetesës.

Poezia përmend shpatet që mbajtën “beteja mbi supe”, një aludim për ngjarjet historike dhe luftërat që kanë ndodhur këtu. *Grykat* dhe *lugjet*, duke u përshkruar si “të thella, të ngushta si grykët e pushkëve”, krijojnë lidhjen mes natyrës dhe luftës, duke i dhënë një kuptim asociativ. Ky përshkrim ku e kaluara është e pranishme e theksohet përmes imazhit tjetër, atij të natës që “ulet” mbi grurë dhe vreshta, duke sjellë një pranëvënie kontrastuese midis natyrës dhe të kaluarës historike të vendit.

Mbi maja, *burbullojnë zjarre që s' shuhen*, është një metaforë që mban lidhje me forcën dhe vitalitetin që i mbetet këtij vendi, duke treguar se pavarësisht kalimit të kohës, ka ende pasion dhe energji që shprehen si zjarr.

Më në fund, poeti përdor pyetje retorike për të shkaktuar një ndjesi zbrazëtie: *Astronom, ku janë yjet? Bari, ku janë zjarret?* Këto pyetje kanë një dimension filozofik, dhe tërheqin lexuesin të mendojë për marrëdhëniet me

trashëgiminë kulturore dhe natyrore, ose, pse jo, për humbjen e lidhjes me natyrën dhe jetën tradicionale, duke gjakuar kështu një rikthim tek origjina dhe vlerat e humbura.

### Në vend të përfundimeve

Studiuesi Robert Elsie, në librin e tij *Historia e Letërsisë Shqiptare* bën zbulimin e veprës së tij dhe karakterit të saj antikonformist: *Xhevahir Spahiu (1945), një nga poetët më të fuqishëm e më të talentuar të Shqipërisë së sotme, mund të quhet një zë i mbijetesës. Gjatë spastrimeve të shkrimtarëve dhe intelektualëve në vitin 1973, diktatori Enver Hoxha e përmendi Spahiun me emër pse kishte shkruar vjershën “Jetë”. Kjo vjershë përmbante vargjet “Jam ai që s’kam qenë, do jem ai që nuk jam”, pse të kujton edhe pse fare rastësisht, një varg të Zhan Pol Sartrit (Jean Paul Sartre, 1905-1980).*

Spahiu hetoi misterin e njeriut dhe ndërgjegjen e një periudhe. Ai nuk e shformoi përthyerjen e jetës në art, pavarësisht trysnisë së metodës. Ai qëndroi kësisoj për t’i dhënë një model epokës, për të treguar në mënyrë të padiskutueshme rrugët e reja të krijimit të poezisë, për të dëshmuar pafundësinë e mundësisë, potencialin e pashterur kreativ, që larushia të mos kishte të nosur... që bota të mos mbetej pa muzikë.

### Bibliografi

- Aliu, Ali. 2005. “Koha e pamposhtur e poezisë”, sipas Xh. Spahiut në: *Udha*. Tiranë: Ideart.
- Elsie, Robert. 1997. *Historia e Letërsisë Shqiptare*. Tiranë.
- Gjikaj, Eldon. 2019. *Realizmi Socialist në sistemin letrar shqiptar*. Tiranë: Albas.
- Jakllari, Adem. 2012. “Xhevahir Spahiu midis “Herezisë” dhe utopisë”, botuar në *Studime Albanologjike*, aktet e konferencës “*Homo Poeticus, Homo Politicus*”. Tiranë.
- Sinani, Shaban. 2010. “Poeti që hapi një portë të mbyllur”, në *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.
- Spahiu, Xhevahir. 1972. *Nëntori*, nr. 12. Tiranë.
- Shaplo, Dalan. 1975. “Pleniumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve kushtuar problemeve të poezisë”, *Revista Nëntori*, nr. 8.

Vinca, Agim. 1997. *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)*. Prishtinë: Enti Botues i Mjeteve dhe Teksteve Mësimore.

## SUMMARY

### **The literary identity of Xhevahir Spahiu against the deformations of socialist realism**

This approach provides a comprehensive overview of Xhevahir Spahiu's literary work, emphasizing his role in shaping contemporary Albanian poetry amid various ideological and generational challenges. It explores how Spahiu, with his unique energy and originality, challenged the traditional and socialist realism paradigms, creating an alternative voice characterized by figurative richness and spiritual depth.

His poetry reflects the complex socio-political landscape, addressing themes of history, nature, and existential struggles, exemplified in poetries which depict feelings of isolation, internal conflict and hope.

Additionally, the analysis highlights a heartfelt ode to homeland, capturing its natural beauty, cultural values, and historical memory through vivid imagery and structured rhythm.

The discussion incorporates critical insights from Robert Elsie, Shaban Sinani, or Aliu Aliu or the poet Ali Podrimja who recognize Spahiu as a resilient figure whose poetry embodies a kind of resistance, vitality, and the ongoing exploration of human consciousness.

Ultimately, the text underscores Spahiu's contribution to Albanian literature as a voice that continuously pushes the boundaries of poetic expression, blending tradition with innovation, and engaging in profound reflections on identity, history, and the human condition.